
**STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ITBundes” Sh.p.k.**

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ITBundes” Sh.p.k.

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ITBundes” Sh.p.k. qe ketu e tutje do te quhet “shoqeria”, dhe zoterohet nga ortaku:

- 1. Individi Z. DR. MUNGWE STANLEY ATAMFORMADELLE, identifikuar me pashaporte me Nr. C6XZLN198, i datelindjes 10/11/1983, me adrese : Rruga Norbert Jokl Ap. 5/506+1-1, Tirane.**

Në përputhje me vullnetin e tij te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë Statut të shoqërisë “ITBundes” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

KAPITULLI I
EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE,
SELIA, TERRITORI

NENI 1
FORMA DHE EMRI

1.1 Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale Sh.P.K., të cilat vijnë përpara ose menjëhere pas emrit të shoqërisë. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë.

1.2 Emri i shoqërisë është “ITBundes” Sh.p.k. Forma dhe emri i shoqërisë mund të ndryshohen me vendim të Asamblese së Pergjithshme të Ortakeve.

NENI 2
BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, në përputhje me legjislacionin shqiptarë në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

NENI 3 SELIA

Selia e shoqërise është në adresën: Rruga Norbert Jokl, Ndertesa Nr. 2, Hyrja 1, Njesia Administrative Nr. 2, Tirane.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim të asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

NENI 4 TERRITORI

4.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Shoqëria mund të krijojë zyra ose perfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyrat, filialet ose përfaqesitë e shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria " **ITBundes** " sh.p.k është e organizuar në formën e një shoqërie që merret me:

- a) zhvillimi i softuerit, transformimi dixhital, marketingu dixhital, shërbimet dixhitale;
- b) Cdo lloj aktiviteti tjetër brenda kuadrit ligjor, me qëllim realizimin e fitimeve në përputhje me objektin e aktivitetit ekonomik të saj;

NENI 6 KOHEZGJATJA

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedurë likuidimi me vendim të Asamblese së Ortakëve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

KAPITULLI III KONFIDENCIALITETI,

DOKUMENTET E DESTINUARA PER TE TRETET

NENI 7

KONFIDENCIALITETI

Ortakët e shoqërise si dhe personat e tjere të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojne asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhe, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 8

DOKUMENTET E DESTINUARA PER TE TRETET

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojne lexueshem emrin e shoqërise dhe pas tij fjalet “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet “Sh.P.K.”, si dhe emrin e administratorit ose te administratorëve.

KAPITULLI IV

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET DHE TRASFERIMI I TYRE

NENI 9

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 Leke (njëqindmije Leke), i ndare në 1 (nje) pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

- Individu Z. **DR. MUNGWE STANLEY ATAMFORMADELLE**, identifikuar me pashaportë me Nr. C6XZLN198, do te zoteroje nje kuote te barabarte me 100 % - 100.000 Lekë (njëqindmijë).

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 10

TE DREJTAT E ORTAKEVE NE LIDHJE ME KAPITALIN

10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve, me shumicën e $\frac{3}{4}$ (tre të katërtave) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise.

10.2 Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar, i përket ortakëve të drejta me opcion mbi kapitalin në zmadhim, në proporcion me kuotën e kapitalit që kanë në pronësi.

Nëse ndonjëri nga ortakët nuk do të nënshkruajë kuotën e tij të kapitalit në zmadhim, e drejta e opcionit do të përket ortakëve të tjerë.

Duke mos e ushtruar ortakët të drejtën e opcionit, kapitali në zmadhim i panënshkruar do të nënshkruhet nga palë të treta.

10.3 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

10.4 Kuotat e kapitalit të shoqërisë nuk mund të rendohen lirisht me barrë siguroese apo të drejta të tjera reale. Në rast shitje të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë për efekt zbatimi të një vendimi gjyqësor apo përmbushje të një detyrimi, enti që ekzekuton vendimin ose detyrimin (zyra përmbarimore ose ndonjë organ tjetër kompetent), duhet të ketë në konsideratë respektimin e kërkesave të nenit 13 të këtij statuti. Secili ortak që rëndon me barrë apo të drejta të tjera reale kuotat e tij, ka detyrimin të shpjegojë nën 13 të këtij statuti subjektin në favor të cilit vendoset barra siguroese.

10.5 Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesëmarrjes në kapital.

10.6 Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e shoqërisë kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërisë, si dhe të konsultojnë dokumentet kontabel e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

NENI 11

FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT

Fusha e autoritetit të ortakëve, përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kontributin e çdo ortaku në kapitalin e shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

NENI 12

FINANCIMI I SHOQËRISË

12.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkojë nga ortakët fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërisë.

12.2 Financimet e mëtejshme të ortakëve do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit jepen këto fonde.

NENI 13

TRASFERIMI I PJESEVE TË KAPITALIT

13.1 Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të transferohen lirisht mes ortakëve të shoqërisë. Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të transferohen tek persona

të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërise në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtes së parablerjes.

13.2 Trasferimi i kapitalit themeltar të shoqërise ose i pjeseve te tij tek persona të tretë behet vetëm në këtë mënyre:

- Oferta per shitje u drejtohet te gjithë ortakeve me shkrim;
- Oferta duhet te percaktoje numrin e kuotave qe shiten dhe çmimin e tyre;

Nese ortakët e shoqërise brenda 3 (tre) muaj nga oferta me shkrim nuk pranojnë blerjen e kuotave te ofruara me çmimin e percaktuar, atehere konsiderohet se ata lejojnë shitblerjen tek te tretet.

13.3 Kapitali themeltar eshte lirisht i trashegueshem ne rruge trashegimie. Bashkeshorti, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar sipas kushteve qe lejohen ne ligj.

13.4 Kalimi i kuotave te kapitalit themeltar duhet te jete i legalizuar nga nje noter i cili depoziton aktin ne organet kompetente.

13.5 Klauzolë miratimi. Nëse asnjë ortak nuk do të ushtrojë të drejtën e parablerjes ne kohe dhe sipas kushteve të parashikuar për transferimin e kuotave apo të drejten e opcionit, kalimi i kuotave nuk do të mund të bëhet pa pëlqimin e Asamblese se Ortakeve që vendos për pranimin e transferimit te nje person i tretë.

Ortakët mblidhen jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) dite, nëpermjet Asamblese të Zakonshme të Ortakeve, duke vendosur me votën pro (ne favor) me të paktën gjysmen e kapitalit themeltar.

13.6 Pëlqimi mund te refuzohet edhe pa nje motiv te justifikuar.

13.7 Nëse miratimi i mohohet do të prezantohet një tjetër blerës. Për këtë qëllim, Asambleja e Ortakeve duhet të tregojë në letrën e refuzimit emrin e blerësit të propozuar; transferimi duhet të plotësohet me të njëjtat kushte të përcaktuara në kërkesën për miratim nga ana e aplikantit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas marrjes së komunikimit të fundit. Përndryshe, ortaku do të jetë i lire për të shitur pjesëmarrjen e tij personit që konsideron me te përshtatshem.

KAPITULLI V

ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 14

ORGANET DREJTUESE

14.1 Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësoje shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise do ti referohemi me termin Asamble e Ortakëve.

14.2 Shoqëria mund të emerojë më shumë se një Administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar Administratorin e shoqërisë “**ITBundes**” **Sh.p.k.**, ky term nënkupton të gjithë Administratorët e saj sado qofshin këta në numër.

14.3 Përveç organeve të parashikuara me sipër Asambleja e Ortakeve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre.

14.4 Administrator i shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emëruar:

Z. DR. MUNGWE STANLEY ATAMFORMADELLE, të cilit i besohen të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm dhe e identifikuar me kartë identiteti Nr. **C6XZLN198**.

KAPITULLI VI **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

NENI 15

VENDIMET E ASAMBLESE TË ORTAKEVE

15.1 Asambleja e Ortakeve vendos për çështjet që ligji apo ky statut i rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e ortakeve.

15.2 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 50 % të kuotave të kapitalit themeltar.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas ligjit mbi shoqëritë tregtare, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortaket që zoterojnë më shumë se 75 % të numrit total të kuotave të kapitalit themeltar janë të pranishëm dhe vendosin me votën e $\frac{3}{4}$ (tre të katertave).

NENI 16

KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKEVE

16.1 Në përputhje me dispozitat e statutit, vendimet e ortakeve mund të merren pas një konsultimi me shkrim që organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Në këto rast, organi administrativ i komunikon ortakeve tekstin e projekt-vendimit që do të merret dhe i kërkon të shprehin vullnetin e tyre në lidhje me këto çështje.

16.2 Vendimet e marra në këto mënyra janë të vlefshme kur vendimi merret nga shumica që ligji apo ky statut kërkon për atë çështje.

NENI 17
MENYRA DHE VENDI I THIRRJES
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

17.1 Asambeja e Ortakeve thirret prane selise se shoqerise, apo ne ndonje vend tjeter brenda Republikes se Shqiperise, nepermjet nje njoftimi me shkrim edhe nepermjet postes elektronike (E-mail), duke e konfirmuar marrjen, qe iu dergohet ortakeve nga Kryetari i Asamblese se Ortakeve dhe / ose Organi Administrativ.

17.2 Njoftimi i thirrjes se mbledhjes se asamblese duhet te kryhet 15 (pesembedhete) dite perpara dates se mbledhjes dhe duhet te percaktoje shprehimisht daten, oren, vendin si dhe rendin e dites. Ne rast pamundesie apo mosveprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e asamblese se ortakeve mund te thirret nga esporti kontabel i autorizuar, nese ka te tille, ose nga nje apo me shume ortake, te cilet perfaqesojne jo me pak se 30% te kapitalit te shoqerise.

NENI 18
KRYETARI I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

18.1 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve emeron Kryetarin e Asamblese.

18.2 Kryetari i Asamblese verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt te Asamblese se Ortakeve, verteton identitetin apo legjitimimin e perfaqesuesit te ortakeve dhe drejton zhvillimin e rregullt te mbledhjes.

NENI 19
PJESEMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak ka te drejten e nje vote per çdo kuote te kapitalit themeltar te shoqerise qe ai zoteron. Nje ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjen e asamblese nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete, nepermjet nje akti perfaqesimi me shkrim.

NENI 20
KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

20.1 Asambleja e Ortakeve mund te jete e zakonshme dhe e jashtezakonshme, kjo ne varesi te çeshtjes per te cilen eshte thirrur. Vendimet e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve merren me shumice te thjeshte te votave te ortakeve. Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve merren me nje shumice te cilesuar prej $\frac{3}{4}$ (tre te katertave) te votave te ortakeve te shoqerise. Per çfare nuk eshte pasqyruar ne kete nene, Asambleja e Ortakeve te shoqerise vendos ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14. 04. 2008.

20.2 Kompetencat e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve do te jene:

- Vendos per perpilimin ose miratimin e rregulloreve per shoqerine apo per fusha te veçanta te veprimtarise.
- Vendos per ndryshimin e selise se shoqerise.

- Vendos per krijimin e zyrave ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive ose te ortakerive me persona te tjere fizike apo juridike.
- Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.
- Emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise, ekspertin kontabel, likujdatorin duke percaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, te drejttat, detyrimet, kohezgjatjen ne detyre, dhe shperblimin e tyre.
- Vendos ne lidhje me krijimin e organeve te tjera drejtuese qe mund t'i nevojiten shoqerise duke percaktuar ne aktet e krijimit te ketyre organeve, kohezgjatjen dhe kompetencat e tyre, per emerimin e personave drejtues te ketyre organeve.
- Asambleja e Ortakeve marrjen e vendimeve e kryen vete dhe nuk ben delegimin e vendimarrjes te asnje organ tjetet. Asambleja e Ortakeve vendos edhe ne lidhje me krijimin e sektoreve te veçante te veprimtarise se shoqerise.
- Shqyrton dhe miraton bilancin vjetor.
- Miraton tarifat e sherbimeve te shoqerise.
- Miraton pagat e te punesuarve ne shoqeri.

20.3 Kompetencat e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve jane:

- Vendos ne lidhje me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Vendos ne lidhje me kohezgjatjen e shoqerise si dhe per mbarimin e likujdimin e saj.
- Vendos per ndryshimin e emrit te shoqerise.
- Vendos ne lidhje me ndryshimin e statutit te shoqerise.
- Vendos per ndryshimin e formes, per ndarjen e shoqerise si dhe per bashkimin e saj me shoqeri te tjera.
- Percakton llojin e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, percaktimin e dividendit, marrjen dhe dhenien e huave, kredive, borxheve.
- Realizon marredheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te shoqerise me persona te tjere fizik apo juridik, vendas apo te huaj.
- Vendos ne lidhje me transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise.

20.4 Pervec kompetencave te lartpermendura, te cilat jane ekskluzive per te, Asambleja e Ortakeve ushtron çdo kompetence qe ia njeh ligji.

20.5 Asambleja e Ortakeve ne rastet kur nuk ka emeruar Administrator, kryen dhe kompetencat qe ne kete Statut jane percaktuar per kete te fundit. Gjithashtu Asambleja e Ortakeve mund te kufizojë Administratorin ne ushtrimin e kompetencave te tij.

NENI 21

ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

21.1 Kompetencat e Administratorit ose te Administratoreve, te cilet mund edhe te mos jene ortake te shoqerise, ne menyre konkrete dhe te detajuar percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Veç te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, Administratori ka edhe keto kompetenca:

- Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet Asamblese se Ortakeve per shqyrtim.
- Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne shoqeri.
- Ndjek problemet e shoqerise ne marredhenie me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- I propozon Asamblese se Ortakeve tarifat e sherbimeve dhe pagat per personelin e punesuar ne shoqeri.
- I propozon Asamblese se Ortakeve rregulloren e shoqerise.
- Administratoret kane te drejte te gjitha sebashku ose veçmas nga njeri tjetri te perfaqesojne shoqerine ne lidhje me te tretet.

21.2 Administratori ose Administratoret jane pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate ushtrimit te administrimit te shoqerise. Pergjegjesia eshte individuale ose solidare, kjo ne varesi te rrethanave dhe te menyres se si eshte vepruar, pra individualisht ose solidarisht.

21.3 Administratori ose Administratoret nuk jane pergjegjes ndaj shoqerise ose te treteve per konfliktin e interesit qe mund te krijohet duke zhvilluar pozicione te ndryshme ose te ngjashme ne shoqeri dhe organizma te ndryshem.

21.4 Shoqeria mund te administrohet nga nje administrator i vetem ose nga shume administratore, nga dy deri ne nente anetar, sipas krijimit nga akti i emerimit. Ne rastin e shume administratoreve, ata mund te formojne nje trup kolektiv, keshilli i administrimit, ose nje trup jo kolektiv, anetaret e te cilit mund te veprojne ne ane te perbashketa, te ndara, ose te miksuara ne baze te asaj qe do te krijohet nga akti i emertimit.

21.5 Nuk mund te emertohet administrator ose perfaqesues dhe, nese emertohet, bie nga zyra e tij, ndalohet, i paafiti, deshtuesi ose kush eshte denuar me nje denim, edhe perkohesisht, nga zyrat publike ose paaftesia ne ushtrimin e zyrave ekzekutive.

21.6 Administratoret kane te gjitha kompetencat e drejtimit te zakonshem ose te jashtezakonshem te shoqerise per zbatimin e qellimit te saj, pervec kompetences se dhene nga vendimi i ortakeve ne perputhje me ligjin. Cdo administrator ose perfaqesues mund te heqi dore ne cdo moment, duke derguar nje njoftim me rakomandate ose me poste elektronike, mundesisht te certifikuar (PEC) tek administratoret e tjere, ne rastin e shume administratoreve, dhe cdo ortakeve. Doreheqja ka efekt te menjehershem nese mbetet ne

detyre shumica e administratoreve ose perfaqesuesve. Ne rast te kundert, ajo ka efekt nga momenti qe emerohet administratori ose perfaqesuesi i ri, vetem nese, te mbetet te pakten nje administrator ose perfaqesues, doreheqja do te pranohet me shkrim nga ana e cdo ortaku tjeter, ne kete rast, komunikimi i administratorit qe jep doreheqjen nderpritet menjehere.

21.7 Cdo administrator ose perfaqesues pushohet nga detyra per skadencen e afatit te themeluar nga akti i emertimit, ne vdekje, per paraqitjen e situatave qe sjellin padrejtesi ose papajtueshmeri per detyren, qofte kjo edhe pa shkak, me vendim te ortakeve. Ne kete rast, nderprerja e kontrates verifikohet kur vendimi per terheqje, i eshte njoftuar nepermjet postes ose me dore administratorit ose perfaqesuesit te revokuar. Revokimi, ne mungese te nje shkaku, nuk sjell asnje te drejte per te kompesuar demet.

21.8 Keshilli i Administrimit. Keshilli administrimit perbehet nga nje numer anetaresh i vendosur nga akti i emertimit, nga te cilet eshte zgjedhur presidenti dhe zevendes presidenti, nese nuk eshte bere nga vendimi i ortakeve. Keshilli i administrimit, mbledh si ne zyren qendore ashtu edhe tjeterkund, sa here e gjykon te nevojshme, te pakten nje keshilltar ose, nese eshte emeruar, kryetari i komunes ose auditori.

Procedura ne mbledhjet e keshillit mund edhe te behet nepermjet mjeteve te telekomunikimit, me kushtin qe te gjithe pjesemarresit mund te identifikohen dhe ti lejohet qe te ndjekin diskutimet, te marrin, te transmetojne ose te shohin dokumente, te nderhyjne duke folur ne kohe reale mbi te gjitha argumentet. Per vlefshmerine e vendimeve te keshillit duhet te jene te pranishem dhe me vota te favorshme nga shumica e anetareve.

Vendimet e administratorit mund edhe te jene te miratuara nga konsultimet me shkrim, ose pelqimin e shprehur me shkrim te derguara me telegram, telefaks ose e-mail brenda periudhes se specifikuar ne kerkese. Ne kete rast aplikohen te gjitha dispozitat e diktuar lidhur me vendimet e ortakeve nga paktet sociale prezente.

Brenda kufijve ligjore, keshilli i administrimit mund te delegoje fuqine e tij, te gjithen ose nje pjese, tek nje ose disa anetareve te tij.

KAPITULLI VII **KONTROLI KONTABEL,** **BILANCI, DIVIDENTET**

NENI 22 **KONTROLI KONTABEL**

Kontrolli i jashtem kontabel i shoqerise kryhet nga eksperte kontabel te autorizuar, sipas legjislacionit ne fuqi. Asambleja e Ortakeve do te emeruje nje apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

NENI 23
BILANCI DHE REZERVAT

23.1 Bilanci mbyllet ne 31 dhjetor te çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar, i paraqiten per shqyrtim asamblese se ortakeve, e cila vendos mbi miratimin, ndryshimin ose rrezimin e ketyre akteve, kur e konsideron te nevojshme Asambleja e Ortakeve mund te beje rekomandimet e nevojshme ne lidhje me çeshtjen ne diskutim.

23.2 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori i vetem merr masat e nevojshme per hartimin e projekt-bilancit te aktivitetit per vitin financiar te mbyllur, ne menyre qe Asambleja e Ortakeve te vendose mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve te percaktuara nga ligji.

23.3 Asambleja e Ortakeve vendos mbi ndarjen ndermjet ortakeve te shumave qe rezultojne si fitime sipas bilancit te aprovuar rregullisht, pasi nga keto shuma te jene zbritur humbjet e mundshme te viteve te meparshme, si dhe te jene lene menjane shumat e nevojshme per krijimin e rezerves ligjore. Rezerva ligjore krijohet vit pas viti nepermjet lenies menjane te nje shume te barabarte me 5 % te fitimit neto te realizuar gjate secilit vit financiar, deri sa te arrihet nje shume e barabarte me 10 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

23.4 Asambleja e Ortakeve ne çdo moment mund te vendose krijimin e rezervave te tjera, si dhe masen e tyre.

KAPITULLI VIII
MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE,
LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

NENI 24
MBARIMI

Shoqeria mbaron me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsyet e parashikuara ne ligj.

NENI 25
LIKUJDIMI

25.1 Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja e Ortakeve cakton nje ose disa likujdues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

25.2 Ne fund te procesit te likujdimit, Asambleja e Ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

25.3 Mbas pagimit te kreditoreve Asambleja e Ortakeve mban pjesen e mbetur te kapitalit qe u shperndahet ortakeve.

NENI 26

LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

26.1 E drejta e largimit lejohet në rastet e parashikuara me ligj.

Njoftimi i largimit duhet ti dërgohen shoqërisë me shkrim dhe duhet të përfshijë emër mbiemer të ortakut që largohet, vendbanimin, për komunikimet e nevojshme mbi procedurën e largimit dhe numrin e kuotave në lidhje me të cilat synon të largohet motivimet përkatëse.

Ortakët që largohen nga shoqëria kanë të drejtë të marrin një rimbursim të kuotave në proporcion të kapitalit të shoqërisë. Për këtë qëllim është përcaktuar duke marrë parasysh vlerën e tij të llogaritur në bazë të kapitalit neto.

26.2 Shlyerja e kuotave për të cilën është ushtruar e drejta e largimit duhet të bëhet brenda 90 (nentedhjetë) ditëve nga komunikimi që i bëhet shoqërisë. Ajo gjithashtu mund të bëhet me anë të blerjes nga ortakët e tjerë në proporcion me pjesëmarrjen e tyre.

Për këtë qëllim, administratorit i kërkohet që të njoftojë ortakët e tjerë mbi mbarëvajtjen e procedurës së largimit të ortakut, dhe t’ia ofrojë për shitje, në emër dhe për llogari të ortakut që largohet, pjesën mbi të cilën është ushtruar largimi, duke deklaruar çmimin e kuotes dhe afatin për pagesën e saj, jo më shumë se 3 (tre) muaj. Për shitjen zbatohen rregulla mbi ushtrimin e së drejtës të parablerjes në këtë Statut.

26.3 Ortakët duhet të informojnë shoqërinë për qëllimin e tyre për të blerë kuotat e ortakut që largohet ose emrin e palës së tretë blerëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e komunikimit nga shoqëria dhe qëllimin e ortakut për t’u larguar. Nëse oferta është pranuar nga shumica e ortakëve, pjesa e ortakut që largohet do të ndahet në proporcion midis ortakeve në baze të kuotave përkatëse që kanë në kapitalin themeltare.

Nëse kjo nuk ndodh, rimbursimi do të bëhet duke përdorur rezervat e disponueshme ose në mungesë përkatësisht zvogëlimin e kapitalit; nëse nuk është e mundur një rimbursim i kuotave të ortakut që largohet, atehere shoqëria vendoset në likujdim.

26.4 Përjashtimi i ortakut mund të bëhet, në rast të vonesës apo pamundësisë së kryerjes të punës ose shërbimeve që mund të kryhen nga një ortakë.

Përjashtimi duhet të përcaktohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve me tre të katërtat e votave.

Pas zbulimit të vendimit për të përjashtuar ortakun, ky i fundit është i penguar për të ushtruar të drejtat shoqërore.

26.5 Për likuidimin e kuotës të ortakut që largohet, aplikohet procedura e rimbursimit e parashikuar për largimin, përjashtuar këtu mundësia e shlyerjes së kuotës nëpërmjet reduktimit të kapitalit themeltare dhe likuidimin e mundshëm të shoqërisë.

Përjashtimi mund të revokohet, derisa kuota e ortakut të përjashtuar nuk i është rimborsuar.

KAPITULLI IX **MOSMARREVESHJET DHE DISPOZITA TE FUNDIT**

NENI 27

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Çdo mosmarreveshje a konflikt ne lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kesaj shoqerie, ortaket do te angazhohen se do ta zgjidhin me mirekuptim, dhe ne rast se kjo nuk arrihet kompetente per gjykimin e mosmarreveshjeve a konflikteve te mundshme do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 28

DISPOZITA TE FUNDIT

28.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptare. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptare ne fushen e shoqerive tregtare si dhe legjislacioni shqiptare ne pergjithesi.

28.2 Shoqeria do te kete vulen, stemen, logon dhe faqen e internetit (website), format dhe madhesite do te percaktohen nga asambleja e ortakeve ne veçanti dhe me propozim te administratorit.

28.3 Ky akt themelim është hartuar në 2 (dy) ekzemplare, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 07.01.2024

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

ITBundes

DR. MUNGWE STANLEY ATAMFORMADELLE

